

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6361
E hënë, 12 korrik 2021
çmimi 0.40 €

Gërvalla thotë se Kosova
s'duhet ta fajësojë BE-në për
gabimet e veta, deklarata e saj
ngjallë reagime **F. 7**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ISH-KRYETARI I GJYQTARËVE TË EULEX-it, MALCOLM SIMMONS, SOT (E HËNË)
DO TË PARAQITET NË KOMISIONIN PËR LEGJISLACION TË KUVENDIT TË KOSOVËS **F. 3**

SIMMONSI SOT RAPORTON PARA DEPUTETËVE PËR SKANDALET E EULEX-it



Ish-kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Malcolm Simmons, sot (e hënë) do të raportojë para Komisionit Parlamentar për Legjislacion për pretendimet e tij ndaj këtij misioni. Ndonëse është mirëpritur ky raportim, njohësit e çështjeve të drejtësisë në vend kanë shprehur skepticizëm se pretendimet e Simmonsit për korrupsion dhe ndikime politike në EULEX do të mund të hetohen. Drejtori i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka bërë me dije për gazetën se Kosova nuk mund të formojë ndonjë komision hetimor ndaj EULEX-it

OPINION

**KTHESA PROAMERIKANE
E KRYEMINISTRIT KURTI** **F. 10**

Shkruan: Hisen
BERISHA



AKTUALE



**DRAMAT E GJYKATËS
SPECIALE PËR VIZITAT E
KADRI VESELIT NË KOSOVË** **F. 6**

**TË RINJTË NË KOSOVË: PAK
PARA PËR PAK PUSHIME** **F. 6**

**DRENORI THEMELON
INICIATIVËN QYTETARE
'GREEN PER DRENAS'** **F. 9**

**919 TË VAKSINUAR NË 24
ORËT E FUNDIT NË KOSOVË** **F. 6**

EKONOMI



**KOSOVA PA APLIKACION
PËR ÇMIMET E DERIVATEVE
TË NAFTËS** **F. 8**

**DIASPORA E GATSHME T'I JAPË
KREDI QEVERISË SË KOSOVËS** **F. 8**



KOSOVA KUJTON GJENOCIDIN NË SREBRENICË: KEMI PASUR PËRJETIM TË NJËJTË

Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë përkujtuar gjenocidin e Srebrenicës, masakrën më mizore që ka njohur Evropa pas Luftës së Dytë Botërore. Në 26-vjetorin e kësaj ngjarjeje të dhimbshme, ata kanë vlerësuar se askush më

mirë se populli i Kosovës nuk e kupton dhimbjen e popullit boshnjak. Sipas tyre, të njëjtat vuajtje nga regjimi i Millosheviqit i ka përjetuar edhe populli i Kosovës. Ata kanë kërkuar të dënohen kriminelët e kësaj masakre **F. 4-5**

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Partitë në Maqedoninë e Veriut nisin fushatën para kohe

SHKUP, 11 KORRIK (ER) - Ende pa filluar zyrtarisht fushata për zgjedhjet lokale që do të mbahen në tetor, partitë politike në Maqedoninë e Veriut kanë shtuar takimet me qytetarë.

Organizatrat joqeveritare, që monitorojnë punën e komunave, kanë thënë se partitë politike në këtë mënyrë po synojnë ta konsolidojnë anëtarësinë e tyre. Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, ka afat që deri në fund të gushtit ta caktojë datën e zgjedhjeve lokale. Këto do të jenë zgjedhjet e shtata lokale prejse Maqedonia e Veriut ka shpallur pavarësinë më 1991.

Strukturat e partive politike thonë se po organizojnë takime me qytetarët në qytetet e ndryshme maqedonase pasi, siç thonë, duan t'i dëgjojnë drejtpërdrejt problemet e tyre, në mënyrë që të premtojnë investime në projekte që janë në interes të qytetarëve.

Pjesa më e madhe e ministrave të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, që vijnë nga Lidhja Social-Demokrate (LSDM), nën moton "Më e mira për komunën tonë",



po promovojnë edhe projekte që janë në kompetencë të pushtetit qendror, si: ndërtimi i kopshteve, sallave sportive e të ngjashme.

Ndërsa partia opozitare maqedonase VMRO-DPMNE po organizon tubime, ku zyrtarë të lartë po diskutojnë për tema të caktuara dhe, përveç tyre, në këto ngjarje po marrin pjesë edhe ish-zyrtarë të kësaj partie.

Edhe partitë politike shqiptare kanë shtuar takimet e tyre me qytetarë për t'i dëgjuar, siç kanë thënë, për shqetësimet e tyre.

Aleksandar Cvetkovski nga organizata joqeveritare "AGTIS"

që monitoron punën e komunave ka thënë se partitë politike, qoftë ato në pushtet apo në opozitë, kësaj radhe kanë dalë më herët në terren për t'i fituar votat e qytetarëve. Sipas tij, duke u bazuar në sondazhe të shumta që sugjerojnë se një numër i madh i qytetarëve nuk pritet të dalin në zgjedhje, për shkak të zhgënjimit me autoritetet komunale, partitë politike kanë vendosur që të dalin më herët në terren për ta vlerësuar nga afër situatën në mënyrë që të mund ta mobilizojnë anëtarësinë e tyre. "Premtohet ky ose ai projekt.

Madje shkelen edhe ligjet, sepse po asfaltohen edhe hyrjet në oborre, gjë që është në kundërshtim me dispozitat ligjore. Por, kjo mendoj se nuk do t'u sjellë shumë dobi partive politike, sepse kjo ka edhe anën tjetër të medaljes - mosrealizimin e premtimeve që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës në komuna, shërbimet më të mira administrative, shkollat, terrenet sportive etj. E theksoj, kjo nuk do t'u sjellë dobi partive, pasi qytetarët janë të zhgënjyer me punën e kryetarëve të komunave dhe përnjëherë, pak muaj para zgjedhjeve, partitë sërish po dalin në terren", ka thënë Cvetkovski për "Rel".

Anketa e Qendrës për Hulumtime Anketuese e Institutit Ndërkombëtar Republikan IRI ka nxjerrë në pah se pjesa më e madhe e të anketuarve nuk i njohin përfaqësuesit e tyre në pushtetin lokal, ndërkaq mbi gjysma e të anketuarve thanë se ata nuk janë të kënaqur me punën e kryetarit aktual në komunën ku ata jetojnë.

Në këtë drejtim, profesori universitar, Arsim Sinani, ka

thënë për "Radion Evropa e Lirë" se rezultatet e këtyre hulumtimeve janë arsyeja që udhëheqësit komunalë po mbajnë takime me qytetarë, para se zyrtarisht të nisë fushata. Sipas tij, partitë kanë për synim që t'i bindin qytetarët që t'i votojnë. "Kryetarët aktualë të komunave, pjesa më e madhe e tyre, do të synojnë që ta vazhdojnë qeverisjen e komunave. Por, më e rëndësishmja është se në këto zgjedhje, qytetarët përmes votës do t'i ndëshkojnë (politikanët), pasi nëse është një kandidat i mirë, nuk do të luajë më rol partia politike, por rol kyç do të ketë besimi i qytetarëve te një person i caktuar i cili mund t'i bëjë ndryshimet", ka thënë Sinani.

Asnjë parti politike nuk ka treguar ende nëse do të bëjë koalicion me ndonjë parti tjetër, pasi thonë se janë duke analizuar ende sondazhet që i bëjnë vetë subjektet. Sipas Kodit Zgjedhor në Maqedoninë e Veriut, fushata për zgjedhjet lokale nis tri javë para zgjedhjeve ndërsa, sipas ligjeve në fuqi, kushdo që keqpërdor fushatën zgjedhore, përgjigjet para drejtësisë.

Afganistani kërkon nga Evropa ta pezullojë dëbimin e emigrantëve

KABUL, 11 KORRIK - Kabuli zyrtar ka kërkuar nga vendet e Evropës që ta ndalojnë dëbimin e detyrueshëm të azilkërkuesve afganë gjatë tre muajve të ardhshëm për shkak të dhunës në rritje të talibanëve dhe përkeqësimit të pandemisë së koronavirusit në Afganistan. "Situata e luftës" dhe vala e tretë e infeksioneve me koronavirus kanë shkaktuar trazira ekonomike dhe sociale në Afganistan, ka thënë Ministria e

Refugjatëve dhe Riatdhesimit e Afganistanit.

Në deklaratën e saj është thënë se "situata aktuale në vend nuk është e përshtatshme për kthimin e detyrueshëm të emigrantëve".

Deklarata, po ashtu, ka shprehur shqetësim për rritjen e numrit të të zhvendosurve brendapërbrenda Afganistanit.

Talibanët janë duke shtrirë kontrollin në gjithnjë e më shumë territore, prejse forcat

ndërkombëtare, të udhëhequra nga ShBA-ja, kanë nisur zyrtarisht tërheqjen nga Afganistani më 1 maj.

Me gjithë rritjen e pasigurisë në vendin e shkatërruar nga lufta, shumë shtete evropiane po i dëbojnë azilkërkuesit e refuzuar të Afganistanit.

Ky vend ka regjistruar më shumë se 131 mijë raste me koronavirus dhe mbi 5 500 viktima prejse ka nisur pandeminë në pranverën e vitit të kaluar.



Papa udhëheq lutjet nga ballkoni i spitalit



ROMË, 11 KORRIK - Papa Françesku është shfaqur në publik për herë të parë qëkur iu nënshtrua operacionit për një problem në zorrën e trashë, një javë më parë.

Duke qenë në gjendje të mirë shëndetësore, Papa, 84 vjeç, ka udhëhequr lutjet javore nga një ballkon i Spitalit Gemelli në Romë. Qindra njerëz janë mbledhur jashtë spitalit.

"Jam i lumtur që jam në gjendje të mbaj takimin e së dielës Angelus edhe nga këtu. E kam ndier thellësisht afërsinë tuaj dhe mbështetjen e lutjeve tuaja.

Faleminderit nga zemra!", ka thënë ai.

Disa fëmijë pacientë janë shfaqur së bashku me Papën në ballkon. Nuk është ende e qartë se sa kohë do të qëndrojë ai në spital.

Vatikani ka thënë se Papa i është përgjigjur mirë trajtimit. I lindur në vitin 1936 në Buenos Aires, Françesku ka humbur një pjesë të mushkërive në moshën 21-vjeçare. Ai, gjithashtu, vuan nga një problem në ijë. Në vitin 2014 atij i është dashur të anulohet një numër angazhimesh për shkak të një sëmundjeje të stomakut.

ISH-KRYETARI I GJYQTARËVE TË EULEX-IT, MALCOLM SIMMONS, SOT (E HËNË) DO TË PARAQITET NË KOMISIONIN PËR LEGJISLACION TË KUVENDIT TË KOSOVËS

Simmonsit sot raporton para deputetëve për skandalet e EULEX-it



Ish-kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Malcolm Simmons, sot (e hënë) do të raportojë para Komisionit Parlamentar për Legjislacion për pretendimet e tij ndaj këtij misioni. Ndonëse është mirëpritur ky raportim, njohësit e çështjeve të drejtësisë në vend kanë shprehur skepticizëm se pretendimet e Simmonsit për korrupsion dhe ndikime politike në EULEX do të mund të hetohen. Drejtori i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka bërë me dije për gazetën se Kosova nuk mund të formojë ndonjë komision hetimor ndaj EULEX-it

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 11 KORRIK - Ish-kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Malcolm Simmons, do të raportojë sot (e hënë) në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit rreth pretendimeve të tij për korrupsion në këtë mision.

Njohësit e çështjeve të drejtësisë në Kosovë e kanë mirëpritur një gjë të tillë, ndonëse kanë thënë se ky raportim do të jetë vetëm informues.

Drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, ka bërë me dije se për pretendimet e Simmonsit Kosova nuk mund të formojë ndonjë komision

hetimor. "Dyshoj që Kosova do të duhej të formonte komision hetimor për këtë rast, pasi kemi të bëjmë për një çështje shumë delikate. Kemi të bëjmë një ish-gjyqtar të EULEX-it, kemi të bëjmë me një marrëveshje në mes të Kosovës edhe Bashkimit Evropian për misionin e EULEX-it, andaj çdo raportim i Simmonsit mund ta konsiderojmë të mirë, pasi Kosova mund të marrë praktikën e mira apo të këqija të misionit të EULEX-it dhe gjatë kohës kur kemi të bëjmë me plotësim-ndryshimin e ligjeve për gjyqësorin, në njëfarë mënyrë të mos përsëritim gabime të tilla. Sidoqoftë, një hetim parlamentar nga ana e Kuvendit të Kosovës do të kishte pasoja në kuptim të raporteve Kosovë - BE", ka thënë

Miftaraj për gazetën "Epoka e re". Sipas tij, Kosova është e pafuqishme të ndërmarrë ndonjë masë ndaj zyrtarëve të EULEX-it. "Më shumë është me pas informata për punën e EULEX-it në Kosovë, por qoftë në aspektin penal apo civil, e administrativ, thjesht Kosova është e pafuqishme dhe s'mund të marrë asnjë masë ndaj zyrtarëve të BE-së. Vlerë e shtuar është t'i marrim praktikën e mira, mirëpo në aspektin e zbulimit diçka të re nuk do të ndodhë, pasi raporti i auditimit i BE-së i paraqet të gjitha", ka thënë Miftaraj.

Ai ka treguar se imuniteti i zyrtarëve të EULEX-it është i garantuar me marrëveshjen që Kosova ka nënshkruar me BE-në. "Misioni i UNIMIK-ut dhe misioni i EULEX-it në Kosovë kanë pasur imunitet të plotë në kuadër të hetimit të gjyqësorit. Përjashtimisht, kjo ka mundur të revokohet nëse për një rast të caktuar Kosova fillon hetimet ndaj këtyre personave, por që pastaj imunitetin duhet marrë nga përfaqësuesit e Bashkimit Evropian në Bruksel. Sidoqoftë, në rastin konkret, nëse flasim për raportimin e Simmonsit dhe ato që i ka thënë deri më tani në publik, mund të themi se këto pretendime janë hetuar nga ana e zyrës së auditimit brenda BE-së dhe kanë dalë me një raport para disa vjetëve ku janë dhënë rekomandimet për misionin e EULEX-it në mënyrë që të mos përsëriten gabimet e njëjta", ka thënë ai.

Pretendimet e Simmonsit

Në muajin qershor ish-kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it, Malcom Simmons, ka shprehur dilema të mëdha në lidhje me funksionimin e Gjykatës Speciale dhe korrupsionin brenda misionit EULEX. Në një letër dërguar më 3 qershor kryeministrit Albin Kurti, Malcom Simmons ka treguar në detaje pretendimet për keqpërdorime të EULEX-it në raste të ndryshme kundër ish-krerëve të UÇK-së. Në këtë letër ai ka bërë me dije se EULEX-i ka bashkëpunuar me Prokurorinë e Serbisë, duke dërguar edhe dosje kundër Kosovës. Përveç ndikimeve politike, bashkëpunimit të EULEX-it me prokurorinë në Beograd, ai ka dhënë detaje dhe ka shprehur dilema edhe për punën e Gjykatës Speciale.

Në dëshminë e tij 25-faqëshe drejtuar Kurtit, Simmons ka shkruar se prokurori i parë i specializuar i Gjykatës Speciale në Hagë, David Schwendiman, ishte përjashtuar për shkak se nuk kishte gjetur prova për krerët e UÇK-së. "Pas themelimit të Dhomave të Veçanta të Kosovës, fillon të dëgjoja thashetheme që qarkullonin te menaxhmenti i lartë, se Brukseli nuk ishte i kënaqur me prokurorin e Dhomave të Veçanta, David Schwendeman, sepse zyra e tij nuk kishte ngritur aktakuza.

Insinuata në atë kohë ishte se zyra e prokurorit kishte menduar se provat kundër disa anëtarëve të profilit të lartë të UÇK-së ishin të pamjaftueshme. Isha i informuar se diskutimet vazhdonin në Bruksel me pikëpamjet që z. Schwendeman të zëvendësohej nga një person tjetër që do të mund t'i besohej", është thënë në letër/dëshminë e Simmonsit.

Me kërkesën që të raportojë në Kuvend, Simmons ofroi edhe dëshmi të tjetra. "Para caktimit tim kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it, isha në dijeni për diskutimet brenda EULEX-it në lidhje me transferimin e dosjeve tek autoritetet prokuroriale të Serbisë. Unë, gjithashtu, isha në dijeni për bisedimet e vazhdueshme ndërmjet prokurorëve të EULEX-it dhe atyre të Serbisë. Në të vërtetë, prokurorët e EULEX-it udhëtonin në Serbi në shumë raste, për t'i diskutuar lëndët me prokurorët serbë. Kur u bëra kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it më 2014, zbulova që me dhjetëra dosje të krimeve të luftës u ishin dorëzuar autoriteteve prokuroriale në Serbi", ka shkruar Simmons. Deri më tani askush nga Qeveria e Kosovës nuk ka kthyer përgjigje për letërën e Malcom Simmonsit. Malcolm Simmons, ish-kryetar i gjykatësve në EULEX, pati dhënë dorëheqje nga ky institucion duke akuzuar EULEX-in dhe BE-në për korrupsion.



SHËNOHET 26-VJETORI I MASAKRËS SË SREBRENICËS

Kosova kujton gjenocidin në Srebrenicë: Kemi pasur përjetim të njëjtë

Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë përkujtuar gjenocidin e Srebrenicës, masakrën më mizore që ka njohur Evropa pas Luftës së Dytë Botërore. Në 26-vjetorin e kësaj ngjarjeje të dhimbshme, ata kanë vlerësuar se askush më mirë se populli i Kosovës nuk e kupton dhimbjen e popullit boshnjak. Sipas tyre, të njëjta vuajtje nga regjimi i Millosheviqit i ka përjetuar edhe populli i Kosovës. Ata kanë kërkuar të dënohen kriminelët e kësaj masakre

EPOKA ERE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 KORRIK - Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë kujtuar të dielën gjenocidin në Srebrenicë. Në 26-vjetorin e masakrës më mizore që ka njohur Evropa pas Luftës së Dytë Botërore, ata kanë vlerësuar se populli i Kosovës e kupton më së miri dhimbjen e popullit boshnjak. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se populli i Kosovës ka përjetuar të njëjtën dhimbje. "Akte të tilla barbare duhet ta marrin gjykimin e drejtësisë, por edhe të historisë. Srebrenica është kujtesa jonë e freskët dhe leksion se krimet e padënuara përbëjnë bazë që ato të përsëriten. Askush më mirë se Kosova nuk e njeh dhimbjen e Srebrenicës. Reçaku, Meja, Pokleku, Prekazi, si dhe shumë

masakra të tjera në pjesë të ndryshme të Kosovës, janë pjesë e të njëjtës dhimbje e të njëjtit përjetim", ka shkruar Osmani në profilin e saj në "Facebook".

Ajo ka vlerësuar se këtë fakt duhet ta pranojë çdokush. "Ka vetëm një të vërtetë: në Srebrenicë ka ndodhur gjenocid. Këtë duhet ta pranojë secili, këtë duhet ta themi të gjithë, këtë duhet ta kujtojmë gjithnjë! Qoftë i përjetshëm kujtimi për më shumë se 8 000 të masakruarit në Srebrenicë!", ka shkruar ajo.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vlerësuar se kriminelët e kësaj masakre duhet të dënohen. "Ne duam paqe, bashkëpunim dhe barazi mes kombeve në Ballkan, por themeli i asaj paqeje është ndëshkimi i kriminelëve. Është e pamendueshme se si, edhe në shekullin XXI, ka politikanë në rajonin tonë që thonë se ata që

kërkojnë ndëshkimin e fajtorëve për gjenocid qenkan kundër dialogut e kundër fqinjësisë së mirë. Përkundrazi, e vetmja fqinjësi e mirë zhvillohet duke dënuar krimet e vendosur drejtësi, dhe i vetmi dialog i mirë ndodh kur palët nuk tremben nga distancimi prej krimeve. I përjetshëm qoftë kujtimi i viktimave të gjenocidit në

Srebrenicë! Kurrë më mos pastë Ballkani, as bota, pushtete e shtete me ambicie gjenocidale", ka shkruar Kurti në profilin e vet në "Facebook".

Edhe liderët opozitarë kanë përkujtuar gjenocidin e Srebrenicës. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka bërë me dije se në këtë përvjetor duhet të përballlemi me këdo që përpiqet ta retushojë historinë dhe t'i mohojë krimet e shovinizmit serb. "26 vjet më parë ndodhi një nga krimet më makabër që njeh qytetërimi bashkëkohor, gjenocidi i Srebrenicës. Ne sot jo vetëm që duhet t'i kujtojmë viktimat e Srebrenicës, por edhe të përballlemi me këdo që përpiqet ta

retushojë historinë dhe t'i mohojë krimet e shovinizmit serb. Mohimi përbën fazën e fundit të një gjenocidi, ndërsa harresa përbën një krim të ri përkundrejt viktimave", ka shkruar ai në profilin e vet në "Facebook".

Kurse kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AKK), Ramush Haradinaj, ka shkruar në profilin e vet në "Facebook", se edhe populli i Kosovës ishte viktimë e regjimit të Millosheviqit. "Kujtojmë sot mijëra jetë të shuara në Srebrenicë, nga regjimi mizor i Millosheviqit. Njerëz të pambrojtur e pa asnjë faj, përfshirë edhe fëmijë, gra e të moshuar, pësuan nga projektet shoviniste të realizuara përmes gjenocidit. Populli i Kosovës, i cili ishte viktimë e të njëjtit terror shtetëror, i kupton më së miri dhimbjet, përjetimet dhe vuajtjet e popullit boshnjak dhe bashkëndien me ta!", ka shkruar Haradinaj.

Disa ditë më parë Kuvendi i Kosovës ka miratuar një rezolutë me të cilën dënohet gjenocidi në Srebrenicë dhe ftohet Qeveria e Kosovës t'i nderojë viktimat dhe kujtimin e kësaj date. "Fton të gjitha shtetet e rajonit që të bëjnë përpjekje shtesë për t'i nxjerrë para drejtësisë të gjithë ata që janë

Ministrat e Qeverisë së Kosovës marrin pjesë në 26-vjetorin e gjenocidit të Srebrenicës. Në shënimin e 26-vjetorit të masakrës së Srebrenicës ka marrë pjesë edhe një delegacion nga Qeveria e Kosovës e kryesuar nga zëvendëskryeministria Emilia Redzeqi. Bashkë me të janë edhe ministrat Elber Krasniqi dhe Armend Mehaj. Ata janë pritur nga anëtarët e Presidencës Boshnjake Sefik Dzaferovic dhe zyrtarë të tjerë të lartë të Bosnjës. Kjo është hera e parë që Bosnja ka pritur zyrtarë të lartë qeveritarë në një ngjarje të tillë.

Dramat e Gjykatës Speciale për vizitat e Kadri Veselit në Kosovë

PRISHTINË, 11 KORRIK - Më 5 nëntor të vitit 2020 Gjykata Speciale në Hagë ka konfirmuar aktakuzën ndaj ish-kreut të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe ish-kryeparlamentarit të Kosovës, Kadri Veseli. Në këtë datë ai kishte dhënë dorëheqje nga të gjitha pozitat e tij politike, edhe nga të qenit kryetar i PDK-së dhe pati njoftuar se vullnetarisht do të udhëtojë drejt Hagës që t'u përgjigjet akuzave.

Më 5 nëntor 2020 Veseli kishte dalë me një deklaratë publike ku kishte konfirmuar për konfirmimin e aktakuzës dhe për aranzhimet e tij për udhëtimin vullnetar drejt Hagës. Ai pati thënë se ftesa ndaj Speciales është mundësi e mirë t'u përgjigjet dyshimeve dhe thashethemeve që kanë qarkulluar lidhur me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), shkruan "Metro".

"Dje pasdite jam informuar nga Zyra e Prokurorit të Dhomave të Specializuara se gjyqtari i procedurës paraprake ka konfirmuar aktakuzën kundër meje. Përmes kësaj deklarate dua t'i informoj qytetarët e Kosovës se kam bërë aranzhimet e nevojshme për të udhëtuar vullnetarisht drejt Hagës në mënyrë që t'u përgjigjem këtyre akuzave. Nuk do të komentoj më shumë kësaj radhe. Jam i vetëdijshëm se ka njerëz në Kosovë që mendojnë se Dhomat e Specializuara janë një fyerje e luftës sonë historike për ta mbrojtur popullin e Kosovës nga krimet e regjimit të Millosheviqit, por unë nuk e shoh në këtë mënyrë. Unë e

shoh si një mundësi që, më në fund, të përgjigjem ndaj këtyre dyshimeve dhe thashethemeve të rrejshme të cilat kanë qarkulluar për vite të tëra. Qëkur Dick Marty publikoi raportin e tij të pabazuar, ishte e pashmangshme që kjo ditë do të vinte. Ishte e pashmangshme që akuzat e tij të padrejta do të duhej të testoheshin në një gjykatë, në mënyrë që t'u jepej fund një herë e mirë. Kjo është arsyeja që unë e kam përkrahur themelimin e këtij tribunali, dhe kjo është arsyeja që unë tani jam i gatshëm ta luaj rolin tim në këtë proces", kishte thënë Veseli atë ditë.

Për korrektësinë dhe dinjitetin e Veselit lidhur me udhëtimin e tij vullnetar në Hagë ka folur edhe avokati i tij Ben Emmerson në një nga seancat e para të Gjykatës Speciale. Ai kishte kërkuar lirinë e Veselit nga paraburgimi duke thënë se i njëjti nuk është arrestuar dhe kështu ai ka udhëtuar vullnetarisht drejt Hagës. "Dua të kujtoj që z. Veseli duhet të prezumohet i pafajshëm për të gjitha akuzat kur të vazhdojë çështja dhe zoti Veseli të lirohet deri në fillim të procesit. Fakti që është përmendur që Veseli është arrestuar duhet të dini që z. Veseli ka ardhur vullnetarisht sipas marrëveshjes me prokurorinë", ka thënë Emmersoni, i cili ka lexuar edhe deklaratën e Veselit i cili e kishte dorëzuar në ditën kur është sjell në Hagë.

Por, Gjykata Speciale, pavarësisht kësaj, nuk kursehet aspak në dramat e saj të ekzagjeruara e të panevojshme.



Që nga udhëtimi në Hagë, ish-kreu i Partisë Demokratike të Kosovës ka udhëtuar dy herë drejt Kosovës për vizita familjare, e para për vizitë te babai i tij i cili kishte pësuar sulm në zemër, e që doli të ishte hera e fundit që Veseli është takuar me të.

Në vizitën e tij të parë në Kosovë, Veselit nuk iu ndanë asnjëherë dhjetëra vetura të policisë së Dhomave të Specializuara që nga aeroporti, në familjen e tij e në spital ku vizitoi babanë. Forca të shtuara të sigurisë, dramë e panevojshme dhe spektakël, policia e Speciales dhuruan edhe në vizitat e Veselit në Spitalin e Mitrovicës ku po qëndronte i shtrirë babai i Veselit.

Veseli qëndroi në zyrat e EULEX-it në Kosovë dhe në çdo lëvizje të tij, policë dhe vetura të Speciales

e shoqëronin para e mbrapa, ndonëse Veseli ishte vetëdorëzuar dhe kishte udhëtuar vullnetarisht drejt Hagës për t'u përballur me akuzat.

Kadri Veseli ka vizituar Kosovën edhe të shtunën. Veseli nën përcjellje të policisë ka shkuar për vizitë te varri i babait të tij i cili ka ndërruar jetë më 7 korrik. Pas vizitës te varri i babait të tij, Veseli ka qëndruar edhe për pak kohë në shtëpinë e tij.

Ai nën dramën e njëjtë të policisë së Speciales mes për mes Mitrovicës ka shkuar në shtëpinë e tij e cila gjendet në lagjen Bajr të Mitrovicës, ku është lejuar të qëndrojë vetëm me familjen e ngushtë dhe nuk është lejuar të dalë jashtë në tendën e vendosur ku po mbahej e pamja për babanë e tij të vdekur.

Veseli është lejuar të jetë pranë

familjes së ngushtë pas rastit të vdekjes së babait të tij vetëm rreth dy orë, më pas eskorta me vetura të EULEX-i dhe Policisë së Kosovës janë larguar bashkë me Veselin. Ndërkohë, ende nuk është bërë me dije nëse ai do të qëndrojë më shumë në Kosovë, apo do të udhëtojë për në Hagë, ku ende vazhdo të jetë në paraburgim.

Nuk dihet ende se cila është arsyeja e një mase të tillë të sigurisë për një burrështetas që vetëdorëzohet në gjykatë, por Specialja vazhdimisht ka bërë paraqitje të tilla "spektakolare" edhe kur janë arrestuar në Kosovë ish-pjesëtarë të UÇK-së. Përpos Veselit, në paraburgim në Hagë janë edhe Hashim Thaçi, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Salih Mustafa dhe Pjetër Shala.



përgjegjës për planifikimin dhe kryerjen e gjenocidit në Srebrenicë", thuhet në pikën 6 të asaj rezolute.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë konstatoi në vitin 2007 se këto vrasje kanë përbërë gjenocid. Institucione të ndryshme ndërkombëtare, ndër të cilat edhe Parlamenti Evropian, e

kanë shpallur 11 korrikun datë të përkujtimit të masakrës më mizore që ka njohur Evropa pas Luftës së Dytë Botërore.

Në këtë masakër forcat serbe vranë mbi 8 000 burra dhe djem myslimanë. Deri më tani, 47 persona janë dënuar me më shumë se 700 vjet burgim për masakrën në Srebrenicë.

Ish-udhëheqësi i serbëve të Bosnjës, Radovan Karaxhiq, është dënuar me burgim të përjetshëm ashtu si edhe ish-udhëheqësi ushtarak në Bosnje, Ratko Mlladiq. Në 26-vjetorin e masakrës, të dielën, në qendrën përkujtimore Potočari, janë varrosur eshtrat e 19 viktimave të Srebrenicës, të identifikuar së voni.

BE: Në Evropë s'ka vend për mohim të gjenocidit

Shefi i politikës së jashtme i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, dhe komisionari për zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi, kanë vlerësuar se në Evropë nuk ka vend për mohim të gjenocidit në Srebrenicë. Në 26-vjetorin e këtij gjenocidi, përmes një deklarate të përbashkët zyrtarët e lartë të BE-së kanë thënë se është detyrë e përbashkët që ta kujtojmë gjenocidin përgjithmonë. "Në Evropë nuk ka vend për ta mohuar gjenocidin, revizionizmin dhe për të madhëruar kriminelët e luftës. Këto janë në kundërshtim me vlerat më themelore evropiane. Përpjekjet për ta rishkruar historinë janë të papranueshme", është thënë në deklaratën e tyre.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë ka konstatuar në vitin 2007 se këto vrasje kanë përbërë gjenocid. "Gjykatat ndërkombëtare, gjykatat e brendshme në Bosnje dhe Hercegovinë dhe vendet fqinje duhet të vazhdojnë të ofrojnë drejtësi për të gjitha viktimat e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit, si dhe për familjarët e tyre. Paqja mund të ndërtohet vetëm mbi drejtësinë", kanë thënë Borrell dhe Varhelyi, duke shtuar se gjenocidi duhet të dënohet çdoherë. "Nuk mund të ketë mosndëshkueshmëri – gjenocidi është gjenocid, qoftë i kryer në Srebrenicë apo gjetkë", kanë thënë ata. Dy zyrtarët, po ashtu, kanë bërë me dije se Evropa nuk e ka harruar përgjegjësinë e saj për dështim në parandalimin e gjenocidit në Srebrenicë.

Të rinjtë në Kosovë: Pak para për pak pushime

PRISHTINË, 11 KORRIK - Pushimet e verës tashmë kanë nisur dhe një numër i të rinjve në Kosovë po planifikojnë të shfrytëzojnë disa ditë për të udhëtuar jashtë vendit. Disa prej tyre tashmë i kanë përfunduar pushimet ndërsa ka edhe të atillë që, në pamundësi financiare, nuk do të udhëtojnë.

Bregdetet në vendet fqinje, kryesisht në Shqipëri, janë destinacioni kryesor për të rinjtë nga Kosova. Disa prej tyre thonë se i financojnë vetë pushimet, ndërsa disa të tjerë varen ende nga financat e prindërve.

Të rinjtë e anketuar nga "Radio Evropa e Lirë" kanë thënë se mundësitë për të shkuar më larg sesa bregdeti në Shqipëri janë të pakta, në veçanti për shkak të kufizimit të lëvizjes së lirë drejt vendeve të Bashkimit Evropian, marrë parasysh që për qytetarët e Kosovës ende nuk ka liberalizim vizash.

Altin Ademi, student në Kolegjin "AAB" në Prishtinë, ka thënë se gjatë studimeve është edhe duke punuar si kamerier. Pavarësisht se ai ka edhe pasaportë të Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka ndonjë kufizim që të udhëtojë për turizëm, ai thotë se nuk do të shkojë më larg se në Shqipëri për pushime dhe se aty dëshiron t'i shpenzojë fitimet e veta.

"Varet, mbase nja 300 apo 400 euro për një javë. Në fakt, unë e kam pasaportën e Maqedonisë së Veriut, sepse babanë e kam nga Shkupi. Por, në Shqipëri është më afër, më mirë, te njerëzit tanë dhe me ta jemi një. Është më afër dhe më qetë. Ndoshta më larg është edhe më mirë, por për momentin kështu i kemi mundësitë", ka thënë Altini.

Ndërsa Blerona Racaj nga Klina, studente e Matematikës në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se pushimet e verës do t'i

kalojë bashkë me prindërit dhe familjen në bregdetin e Shqipërisë. Pushimet thotë se do t'i financojnë prindërit. "Nuk jam e punësuar, pasi që jam duke studiuar. Rrjedhimisht, na financojnë prindërit. Zakonisht qëndrojmë një javë në Shqipëri për shkak se na pëlqen bregdeti shqiptar. Por, mbase, edhe për shkak të mosliberalizimit të vizave, nuk mund të udhëtojmë më larg. Jemi mësuar në Shqipëri dhe për këtë arsye më shumë shkojmë atje", ka thënë Blerona.

Në anën tjetër, Fitim Merovci, një i ri nga Prishtina, ka thënë se i ka përfunduar studimet dhe tashmë punon. Ai i ka përfunduar edhe pushimet verore për sivjet. "I kam përfunduar në Shqipëri, në Velipojë. Nuk kam qëndruar shumë, dy-tri ditë, sepse thjesht nuk na u duk shumë mirë. Na kanë mjaftuar dy-tri ditë, sepse po bëhet monotonë nëse rrimë

më shumë. Varet edhe prej kushteve. Në qoftë se kushtet janë më të mira, mbase do të shkonim më larg, jashtë fqinjësisë. Të gjithë jemi duke pritur për vizë", ka thënë Fitimi.

Kurse Eleta Emmini, nxënëse e një shkolle të mesme në Prishtinë, ka thënë se planifikon që pushimet t'i kalojë me prindërit. "Zakonisht shkoj me familje, për shkak se i kam 16 vjet dhe nuk mund të shkoj vetë. Për financim, i kemi familjarët, babai që punon në Kosovë dhe i financon pushimet. Nuk jam e sigurt se ku, por me siguri në Shqipëri diku, për shkak se, po të shkojmë diku tjetër, na duhen financa më të mëdha dhe, po ashtu, nuk kemi as liberalizim të vizave dhe nuk mund të shkojmë në Evropë", ka thënë Eleta.

Por, Arian Hysenaj, një shitës ambulant në sheshin "Nëna Terezë" në Prishtinë, ka thënë se, pavarësisht prej dëshirës për të

shkuar në pushime verore, nuk i ka mundësitë financiare për një gjë të tillë. "Nuk ka të ardhura, nuk kemi buxhet tash për tash. S'kemi para për këtë. Tash po rrimë dhe po punojmë nga pak. Nuk kemi mundësi, edhe pse kohë mund të gjejmë për dy-tri ditë. Për dy-tri ditë, nëse shkoj, unë jam vetë i katërti në familje dhe pa i pasur 300 euro nuk mund të shkosh. Tash për tash nuk ka asgjë. Nuk ka para", ka thënë Ariani.

Gjatë verës së vitit të kaluar pandemia e koronavirusit ka shkaktuar kaos në sektorin e turizmit të vendeve me bregdet e që janë në fqinjësi të Kosovës. Udhëtimet nga Kosova për në bregdetin e Shqipërisë dhe Malit të Zi kanë qenë mjaft të reduktuara në krahasim me vitet paraprake. Por, sivjet, të dyja këto vende i kanë ftuar turistët nga Kosova që t'i kalojnë pushimet verore atje.



919 të vaksinuar në 24 orët e fundit në Kosovë

PRISHTINË, 11 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë nuk ka vdekur asnjë person nga Covid-19, ndërsa janë paraqitur 12 raste të reja me këtë sëmundje. Po kjo ministri ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë

vaksinuar mbi 900 qytetarë. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 919 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 253 858 doza të vaksinës. Deri më sot 64 276 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 1 898 testime, 12

qytetarë kanë rezultuar pozitiv me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shëruar 13 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 457. Në total numri i rasteve aktive është 133", ka njoftuar MSh-ja.



Gërvalla thotë se Kosova s'duhet ta fajësojë BE-në për gabimet e veta, deklarata e saj ngjallë reagime

PRISHTINË, 11 KORRIK (ER) - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka thënë se Kosova nuk duhet ta fajësojë Bashkimin Evropian për gabimet e saj. Ajo në një panel diskutimi në Forumin e Dubrovnikut ka lënë të nënkuptohet se vendi ende nuk ia ka dalë të integrohet drejt BE-së si dhe për liberalizim të vizave. "Me gjithë vështirësitë dhe sfidat, duhet konstatuar se BE-ja na ka ofruar më të mirën që ka - perspektivën e anëtarësimit në projektin më të suksesshëm të historisë evropiane. Prandaj, mbi të gjitha për veten tonë, ne duhet të përmbushim detyrat tona: Duhet të ndërtojmë shtetin ligjor, duke përfshirë edhe të qenit të ashpër ndaj korrupsionit. Duhet ta garantojmë lirinë e shtypit dhe të bëjmë reformë të vërtetë ligjore. Ne ende nuk kemi arritur aty. Dhe nuk asnjë arsye pse ta fajësojmë BE-në për gabimet tona. Askush nga ne nuk do të duhej të mashtronte veten duke thënë apo menduar që mund të hyjmë (në BE) pa i kryer punët tona", ka thënë Gërvalla.

Kjo deklaratë e Gërvallës ka ngjallur reagime të shumta në Kosovë. Fillimisht ndaj kësaj deklarate ka reaguar ish-ambasadorja e Kosovës në Uashington dhe zyrtarja e PDK-së, Vlora Çitaku. Ajo ka kërkuar nga Gërvalla që mos ta shtrembërojë të vërtetën, sidomos në lidhje me liberalizimin e vizave. "Para pak javësh në Prishtinë, ministri i Punëve të Jashtme i Gjermanisë konfirmoi atë të cilën Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian po e

përsëritin tani e disa vite: Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave. Keni parasysh, qytetarët e Venezuelës, Kolumbisë e shumë të tjerë deri në Tajvan mund të udhëtojnë pa viza në BE. Askush nuk po thotë se Kosova është gati sot të jetë anëtare e BE-së, sepse ne kemi ende për të bërë në luftën kundër korrupsionit, në sundimin e ligjit dhe në përjetësimin e vlerave evropiane. Por, ta keni të qartë, as brenda BE-së nuk ka uniformitet në zbatimin e vlerave dhe standardeve. Jo të gjitha vendet e BE-së janë në nivelin e Finlandës apo Suedisë. Por, mbi të gjitha, ju jeni ministre të Jashtme të Kosovës. Detyra juaj është ta plasoni Kosovën në dritën e saj më të mirë. Jo të mos e thoni të vërtetën, por as mos ta shtrembëroni atë", ka shkruar Çitaku në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVL-UÇK-së, Faton Klinaku, ka reaguar pas deklaratave të ministres së Punëve të Jashtme të Kosovës, Donika Gërvalla. Nëpërmjet një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook", Klinaku ka thënë se janë vetë zyrtarët e BE-së ata që e kanë pranuar se Kosova ka përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave. Madje ai ka thënë se edhe sa kohë i duhet kryeministrit Albin Kurti që ta durojë Gërvallën. "Të fajësosh Kosovën për mospërmbushje të kushteve duke ia lënë fajin asaj, e të mos e fajësosh BE-në ku edhe zyrtarët e saj kanë thënë se janë përmbushur kriteret, por ka 'divergjenca' në BE, përveç se është amatorizëm politik, është



edhe e dëmshme për Kosovën dhe nuk e di se edhe sa kohë kryeministri Kurti do ta durojë një ministere të tillë të Jashtme", ka shkruar Klinaku.

Edhe drejtori i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka kritikuar ashpër qëndrimin e ministres së Jashtme, Donika Gërvalla, në Forumin e Dubrovnikut. Miftaraj ka thënë se edhe nëse dy ose tre adresime të tilla bëhen nga ministrja e Jashtme, qytetari i Kosovës Evropën do ta përjetojë vetëm si azilant. "Kur politika e jashtme, liberalizimi i vizave dhe promovimi i interesave shtetërore të Republikës së Kosovës kalkulohej për një grusht vota për zgjedhjet lokale të tetorit 2021, është ego për pushtet e assesit për mirëqenie të qytetarit. Edhe dy ose tre adresime të ministres së Punëve të Jashtme dhe qytetari i Kosovës Evropën do ta përjetojë vetëm si azilant apo refugjat

përmes rrugëve ilegale", ka shkruar Miftaraj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa ish-deputetja dhe ish-nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Aida Dërguti, ka thënë se nuk duhet kritikuar vetëm ministrja e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, lidhur me deklaratat e saj që nxitën reagime. Dërguti ka thënë se deklaratat e Gërvallës, përfshirë ato që ajo i vlerëson si "anti-UÇK", e deri tek ajo e djeshmja, janë qëndrime të Qeverisë së Kosovës. "Çka është gjithë ky sulm mbi ministrin Gërvalla? Deklaratat e saj prej atyre anti-UÇK e deri te kjo e fundit janë qëndrime të qeverisë", ka shkruar Dërguti në llogarinë e vet në "Facebook".

Me këto kritika nuk është pajtuar ministrja Gërvalla e cila ka akuzuar disa media për fabrikim të lajmeve. "Të nderuar miq, që nga marrja e detyrës ministre e

Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, portale të caktuara mediale fjalët e mia jo rrallë i kanë paraqitur në formë aq të tjetërsuar, sa krijohet përshtypja të jetë thënë pikërisht e kundërta e asaj që është thënë në të vërtetë. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe sot dhe një qasje e tillë është për keqardhje. Kritika është e mirëseardhur dhe domosdoshme. Fabrikimi i lajmeve të rreme dhe mashtrimi i opinionit nuk është në rregull dhe nuk i bën nder as atyre që i publikojnë, as atyre që më pas mezi presin t'i komentojnë mashtrimet e tilla. Gabime të tilla mund të evitohen shumë lehtë duke komentuar vetëm atëherë kur dihet burimi dhe përmbajtja e tekstit të plotë", ka shkruar Gërvalla në llogarinë e vet në "Facebook". Kjo nuk është hera e parë që ministrja Gërvalla kritikohet për adresimet e saj publike.

Abdixhiku: Ata që u larguan nga LDK-ja do të kthehen në shtëpinë e dikurshme

PRISHTINË, 11 KORRIK (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka deklaruar se "të larguarit" nga kjo parti do të rikthehen "në shtëpinë e tyre të dikurshme dhe bashkërisht do ta rikthejnë partinë në vendin e saj origjinal". Këto deklarime i pari i LDK-së i bëri në një tubim në Lipjan, duke shtuar se në zgjedhjet e tetorit "duhet përfunduar gara me të parën, me Lipjanin si kampion". Abdixhiku ka thënë se Lipjani është model që secili qytetar në Kosovë duhet ta ketë, si dhe shembull që secila komunë duhet ta arrijë. Ai ka theksuar se kryetari Imri Ahmeti është bërë shembull për të gjithë. "Qyteti antik, Ulpiana e dikurshme e Lipjani i sotëm, është transformuar në një qytet shembull për secilin prej nesh, prandaj sot të gjithë ndihemi mirë. E si të mos



ndihemi mirë kur një shteg si ky shoqërohet me gjelbërim gjithandej, me një shesh qyteti që i jep jetë e shpirt për çdo mbrëmje, në verë e në dimër pa

dallim, me parqe atraktive, ndriçime rrugësh e rrugicash, me stadium qyteti, me rrugë të zgjeruara e me projekte transformuese që jetën këtu e

bëjnë fare të lehtë, ku mërgimtarët ndihen të mirëseardhur, siç thonë ata Zvicër andej, Zvicër këndej. Gjithë ky transformim është si falënderim

për secilin prej jush. Është puna juaj e përditshme, e ndershme dhe e sinqertë që ka sjell këtë ndryshim, mbi të gjitha mban për falënderim kryetarin tuajin e tonin, mikun tim e tuajin, Imri Ahmeti", ka thënë ai, duke shtuar se puna e të parit të Lipjanit po vlerësohet nga çdo raport vendor e ndërkombëtar si puna më e mirë në Kosovë. "Gjatë gjithë këtyre viteve dhe gjatë gjithë ecjes sonë të përbashkët, për të gjitha rezultatet e arritura në Lipjan, sot komuna jonë është ndër komunat më të mira në Kosovë, sepse vazhdimisht është në krye të tabelës për performancë të mirë, është kontribut dhe angazhim i qytetarëve të Lipjanit, është angazhim i strukturave dhe i gjithë juve që na përcjellët vazhdimisht me punën dhe aktivitetet të mira", është shprehur Abdixhiku.

Kosova pa aplikacion për çmimet e derivateve të naftës

Një aplikacion në bazë të të cilit qytetarët e Kosovës do të kishin mundësi t'i shihnin çmimet e derivateve në baza ditore është duke u kërkuar të bëhet edhe në vendin tonë me qëllim të transparencës së çmimeve dhe lehtësimit të qytetarëve sa i përket anës financiare. Lidhur me këtë çështje, kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka thënë se është domosdoshme që Kosova ta ketë një aplikacion apo uebfaqe ku qytetarët çdo mëngjes mund të informoheshin se si sillen çmimet e derivateve në Kosovë. Një aplikacion i tillë është kërkuar edhe nga kryetari i OJQ "Konsumatori", Selatin Kaçaniku. Ndërsa eksperti i ekonomisë, Pëllumb Çollaku, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se krijimi i oligopolit në tregun e naftës vazhdon të jetë problem për shkak të koncentrimit të konsumatorëve në pika të caktuara derivatesh

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 11 KORRIK - Përfaqësues të Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, të konsumatorëve dhe ekspertë të ekonomisë, kanë kërkuar që në Kosovë të krijohet një aplikacion në bazë të të cilit qytetarët e Kosovës çdo ditë mund t'i shihnin dhe t'i krahasonin çmimet e derivateve. Edhe pse në pikat e karburanteve janë të vendosura çmimet e derivateve të naftës, me anë të krijimit të një aplikacioni qytetarët do të mund të informoheshin nga kudo në lidhje me lëvizjet çmimeve. Sipas tyre, një gjë e tillë do të ndikonte në të mirë të konsumatorëve, duke përfshirë anën financiare dhe transparencën e çmimeve. Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është domosdoshme që Kosova ta ketë një aplikacion apo uebfaqe ku qytetarët e Kosovës do të mund të informoheshin çdo mëngjes sa janë çmimet e derivateve.

"Besoj se është kërkesë reale dhe kjo duhet të bëhet në ditët në vijim. Shpresoj që Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, do ta realizojë edhe këtë, ku çdo mëngjes qytetarët do ta dinë përafërsisht se si sillen çmimet e derivateve në Kosovë", ka thënë Berjani. Sipas tij, edhe pse në tërë Kosovën janë të vendosura çmimet pranë pikave të karburanteve, një aplikacion i tillë

është më se i domosdoshëm. "Do të duhej ta kemi një program special. Në tërë Kosovën janë të montuara në mënyrë automatike çmimoret, që do të thotë se qytetarët mund t'i shohin çmimet qoftë kalimthi apo kur të ndalen. Megjithatë, një program special apo aplikacion siç është në të gjitha vendet e botës është i nevojshëm", ka deklaruar ai. Lidhur me këtë çështje gazeta "Epoka e re" i ka dërguar pyetje Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që udhëhiqet nga Rozeta Hajdari, mirëpo deri nuk ka kthyer përgjigje.


Ndërsa eksperti i ekonomisë, i cili është ligjërues në Kolegjin "Rinvest", Pëllumb Çollaku, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se krijimi i oligopolit në tregun e naftës vazhdon të jetë problem për shkak të koncentrimit të konsumatorëve në pika të caktuara derivatesh. Sipas tij, krijimi i një aplikacioni të tillë apo platforme online nga e cila do të informoheshin qytetarët e Kosovës do t'u ndihmonte të gjithëve. "Krijimi i oligopolit në tregun



e naftës dhe të derivateve të saj vazhdon të jetë një problem në këtë sektor shkak i koncentrimit të tregut te shumë pak kompani që në të kaluarën dhe tani mbajnë hise të madhe në këtë fushëveprim. Edhe po të kishte informacion në kohë reale mbi çmime në tërë territorin e Kosovës, në çdo komunë, ajo do të ndryshonte fare pak mes tyre si rezultat i një ujdje paraprake të një karteli të tillë për çmime. Në këtë rast, një platforme online e cila do të ofronte informacion mbi çmimet në rajon dhe jo vetëm në Kosovë do të na ndihmonte më shumë të gjithëve për të kuptuar situatën e çmimeve të naftës dhe derivateve të saj, nga të cilat mund të analizohej më lehtë pozita e konsumatorit dhe tregu përkatës në përgjithësi", ka thënë Çollaku. Sipas tij, një platformë e tillë do të ishte në shërbim të qytetarëve dhe të mekanizmave mbikëqyrës të derivateve të naftës në Kosovë. "Të dhënat nga platforma të tilla do të ishin shumë të mirëseardhura sepse do të informonin dhe ndihmonin jo

vetëm konsumatorin, por edhe vendimmarrjen e nevojshme politike për të përmirësuar këto dështime të organizimit të tregut", ka thënë Çollaku, duke shtuar se krijimi i kushteve për një konkurrencë të shëndoshë në të gjithë sektorët e ekonomisë është qenësore. "Normalisht është shtylla bazë e operimit në politika ekonomike të një qeverie", ka deklaruar ai.

Edhe Selatin Kaçaniku nga OJQ "Konsumatori" ka thënë se një aplikacion i tillë do të ishte në leverdi të konsumatorëve dhe do t'u ndihmonte atyre si në aspektin financiar, edhe në atë të cilësisë. "Informimi transparent për çmimet do të ishte një ndër faktorët që do të ndikonte në kënaqshmërinë e qytetarëve, pasi qytetari do të kishte të drejtë të ketë njohuri si për çmimin, ashtu edhe për cilësinë. Nuk duhet harruar se qytetarët e Kosovës duhet t'i kenë të drejtat e tyre konform direktivave, ashtu siç është e paraparë edhe me direktiva të Bashkimit Evropian (BE)", ka deklaruar Kaçaniku për gazetën "Epoka e re".



Diaspora e gatshme t'i japë kredi Qeverisë së Kosovës

PRISHTINË, 11 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka filluar të ofrojë bono të Thesarit për diasporën me qëllim të orientimit të fondeve të diasporës në financime që mundësojnë zhvillimin ekonomik, sidomos pas rënies ekonomike si pasojë e pandemisë Covid-19. Bonot e Thesarit janë letra me vlerë të garantuara nga shteti dhe të emetuara nga Thesari i Kosovës. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe bankat komerciale partnere për lëshimin e bonove të Thesarit për diasporën. Shuma totale e paraparë për këto bono është 20 milionë euro, me mundësi rritjeje deri në 50 për

qind, nëse do të ketë kërkesa. Për ata që blejnë bono të Thesarit me kohëzgjatje trevjeçare, interesin që do ta marrin do të jetë 1.2 për qind, kurse për paratë e investuara për pesë vjet, interesi do të jetë 2.2 për qind. Kuponi i parë i interesit do të paguhet në muajin shkurt, kurse i dyti në gusht dhe kështu do të vazhdojë pagesa çdo gjashtë muaj, deri në përfundimin e marrëveshjes. Krejt në fund, kur përfundon koha e maturimit, personi që i ka lëshuar kredi shtetit, i merr të gjitha paratë e investuara. Yll Blakaj, kryetar i Rrjetit të Bizneseve të Diasporës Shqiptare në Austri, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se emetimi i bonove të Thesarit do të jetë një mundësi më shumë që diaspora

ta ndihmojë zhvillimin e Kosovës. Megjithatë, ai ka thënë se autoritetet e Kosovës është dashur ta konsultojnë diasporën përpara kësaj nisme. "Mendoj se para se të dalin në shitje, në këto bono të Thesarit është dashur të përfshihen aktorët nga diaspora, por edhe nga shoqatat e bizneseve dhe të bisedohet më shumë rreth këtyre bonove, në mënyrë që të informohen më shumë njerëzit, bizneset, rreth formave të investimeve dhe përfitimeve që do t'i marrin", ka thënë Blakaj. Individët dhe bizneset nga diaspora, ka thënë Blakaj, pritet të kenë interesim për bonot e Thesarit. Sipas tij, një gjë e tillë do t'i ndihmojë Kosovës të investojë në projekte strategjike zhvillimore në mënyrë që të



hapen vende të reja të punës. Periudha e shitjes së këtyre bonove do të jetë nga 21 korriku deri më 18 gusht, kurse data e emetimit është më 20 gusht 2021. Shuma minimale për blerje është 10 000 euro, kurse ajo maksimale për një person në një bankë është 500 000 euro.

Investimi në bono është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për borxhin publik, ku interesi i përcaktuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, garantohet për të gjithë kohëzgjatjen, 3 dhe 5 vjet dhe është tërësisht i liruar nga tatimi.

Haziri në fushatën e korrje-shirjeve: Uroj që fermerët të ndahen të kënaqur me bërëqetin që u ka dhënë Zoti

GJILAN, 11 KORRIK (ER) - Gjilani ka nisur fushatën e korrje-shirjeve pas vlerësimit që komisioni komunal ka bërë, se pjekja teknologjike është arritur dhe ka vendosur që fushata të nisë për korrjen e tre mijë hektarëve me grurë, 100 hektarëve me elb dhe 30 hektarëve me tërshërë, sa janë të mbjella këtë vit në Gjilan.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili ka hapur fushatën e korrje-shirjeve në arat e Livoçit të Poshtëm, ka uruar për fushatë të suksesshme dhe bërëqet për fermerët, duke theksuar se në kuadër të punës së tij, fermeri ka qenë fokus kryesor që të punohet toka dhe të zhvillohet veprimtaria bujqësore në të gjitha fushat. "Presim rendimente të mira dhe uroj që fermerët të ndahen të kënaqur me bërëqetin që ka dhënë Zoti. Kushtet klimatike janë shumë të mira dhe besoj që me sukses dhe në kohën optimale të arrihet korrja e të gjitha arave me grurë, elb e tërshërë. Uroj çdo familje bujqësore dhe çdo bujk gjatë mbledhjes së bërëqetit të jenë të kënaqur në familjet e tyre, sikur edhe ne që kemi subvencionuar vazhdimisht bujqësinë që toka të mbillet sa më shumë", ka thënë

Haziri.

Ndërsa drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, ka thënë se në bashkëpunim me komisionin komunal, grumbulluesit e grurit dhe fermerët "kemi vlerësuar se gruri ka arritur pjekjen teknologjike dhe monitorimi do të bëhet vazhdimisht deri në korrjen e ngastrës së fundit". "Së pari falënderoj kryetarin e komunës në emër të të gjithë bujqve, sepse gjatë gjithë kohës kemi qenë pranë tyre me promovim, mbështetje, sjellje të varieteteve të reja, por edhe duke i siguruar ato. Përpos mbështetjes në mekanizëm dhe me forma të ndryshme, kryetari Haziri vazhdimisht është angazhuar për mbështetje të brezit të ri. Pritjet janë për rendimente të larta nga ajo që shihet në terren dhe urojmë që koha të jetë në favorin e të gjithë neve që ta përfundojmë fushatën sipas planifikimit. Komisioni komunal është vazhdimisht në terren dhe po bën kujdesin maksimal që gjithçka të shkojë mirë. Lusim të gjithë fermerët që të jenë të kujdesshëm dhe të mos ndezín ngastrat pas korrjes sepse edhe janë të sanksionueshme, por edhe të dëmshme për tokën", ka porositur



drejtori Ramadani.

Në anën tjetër, Meriton Hajdari, fermer i cili ka të mbjella 25 hektarë me grurë, ka thënë se

është shumë i kënaqur me mbështetjen, derisa ka porositur që Komuna e Gjilanit në këtë mënyrë të vazhdojë edhe më tutje

trajtimin e fermerëve dhe bujqësisë, sepse duhet të punohet dhe ka leverdi nga puna që ai ka bërë.

Qindra qytetarë të Deçanit dyshohet se u helmuan, "Hidrodrini" apelon të mos konsumohet uji



DEÇAN, 11 KORRIK - Mbi 300 qytetarë të Deçanit të shtunën mbrëma kanë kërkuar ndihmë mjekësore në Qendrën e Mjekësisë Familjare mbi dyshime se janë helmuar nga uji i pijes. Lidhur me këtë rast, KRU "Hidrodrini" në Deçan ka lëshuar një njoftim ku ka kërkuar që banorët e fshatrave, Prejlep, Rastavicë, Irzniq, Glogjan, Shaptej, Gramaqel, Baballoq, Ratishë dhe Jasiq i ri të mos e konsumojnë ujin deri në njoftim të radhës. "Pas shfaqjes së dyshimeve të para, të

pavërtetuara deri më tash, KRU 'Hidrodrini', njësi operative në Deçan, në koordinim edhe me autoritetet komunale, ka marrë të gjitha masat urgjente duke hulumtuar shkaqet e mundshme. Njoftojmë se deri në këtë çast nuk ka asnjë bazë të vërtetuar se shqetësimet në fjalë mund të kenë ardhur /ose/ mos ardhur si pasojë e ujit. Andaj, deri në kthimin e analizës së ujit nga ana e IKShPK-së, ky apel mbetet në fuqi", ka njoftuar "Hidrodrini". Se qytetarët kanë kërkuar ndihmë mjekësore e ka

konfirmuar edhe ushtruesi i detyrës së "Hidrodrinit", Petrit Januzaj. Ai ka thënë se së bashku me kryetarin e komunës, Bashkim Ramosaj, kanë dalë në teren. "Sot jam informuar nga kryetari Bashkim Ramosaj për këtë shqetësim që kanë paraqitur qytetarët dhe menjëherë kemi dalë në terren. Kemi marrë masat e nevojshme dhe do të dërgojmë për analiza cilësinë e ujit", ka thënë Januzaj. Ai ka bërë me dije se mostrat e ujit për analiza do të dërgohen sot (e hënë) në mëngjes.

Drenori themelon iniciativën qytetare "Green për Drenas"

DRENAS, 11 KORRIK (ER) - Spektriti politik dhe aktivizmit qytetar në Komunën e Drenasit i është shtuar iniciativa qytetare "Green për Drenas". Kjo iniciativë është themeluar nga aktivistë politikë, intelektualë dhe njohës të çështjeve mjedisore. Pjesë e kësaj iniciative është Xhavit Drenori. Iniciativa qytetare "Green për

Drenas" do të merret me problematika të ambientit jetësor dhe ekologjisë, si një mundësi e re për qytetarët e Drenasit që të angazhohen nëpër mbrojtjen e mjedisit jetësor si prioritet kryesor. Kjo iniciativë do të garojë në zgjedhjet e ardhshme lokale me kandidatin e vet për kryetar dhe me listën për asamble. Me kë

rast, Drenori ka thënë se do të angazhohet për mbrojtjen e mjedisit në Drenas. "Iniciativa dhe unë personalisht premtojmë publikisht që do të zbatojmë një program me planifikime, veprime e ndryshime konkrete, për të adresuar dhe zgjidhur problemet mjedisore dhe të ndotjes së ambientit jetësor, që

në Drenas është në përmasa alarmante. Duke kërkuar vetëdijësim qytetar dhe përkrahjen tuaj në këtë kauzë aspak të lehtë, iniciativa e re qytetare 'Green për Drenas' zotohet që të angazhohet për një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë, për një Drenas më të zhvilluar, për një mjedis me ndotje minimale, ajër të pastër e



ujë të pijshëm për secilin, për një qytet në të cilin të të gjithë qytetarët do të ndihen të vlerësuar e të trajtuar me barazi e drejtësi", ka thënë Drenori.

Rikujtesë me shkas (në vend të reagimit)

ARBËRIA E VOGËL E AZEM GALICËS, BËRTHAMA E SHTETËSISË SË KOSOVËS

AZEM E SHOTË GALICA

(Sfidues historie, frymëzues brezash, amanete të paplotësuara...)

(Dymbëdhjetë vjet të pandarë në lufta e në beteja! Fati sikur ua ktheu shpinën! Trupat e tyre mbeten të ndarë, njëri në Galicë, tjetri në Fushë-Krujë!!! Shqipëria dhe Kosova i nderuan me titujt më të lartë: HERO! Por, ç'e do, or të keqen, kur asnjë dekoratë nuk ka arritur aty ku duhet: te familjarët! Dhe moskujdesi ndaj heronjve vazhdon. Ata ende as pas gati një shekull nuk kanë një shtatore!!!)

Shkruan: Bedri TAHIRI

Kryekomandant i çetave çlirimtare

Të nderuar lexues!

Më 15 korrik mbushën plot 97 vjet nga beteja e fundit e Azem Galicës e cila në popull njihet me emrin Lufta e Galicës, ndërkaq në literaturë si Epopeja e Arbërisë së Vogël. Për Azem Galicën dhe Nusën e Maleve (Shotën) deri sot janë shkruar dhjetëra libra biografikë e studimorë, janë thurur shumë këngë e poezi, janë shkruar shumë tregime e romane, janë bërë edhe disa drama e filma por, mjerisht, ende nuk po mund të realizohen ca nisma të mbara, sepse nuk po gjejnë përkrahjen e duhur nga organet tona shtetërore vendimmarrëse. Kompleksi Përkujtimor "AZEM E SHOTË GALICA" në Galicë, me varrin masiv, me pllakën përkujtimore kushtuar të rënëve të asaj beteje, varri i zbrazët i Shotë Galicës e sidomos KULLA, e mbetur jashtë funksionale e pa përkujdesje institucionale, siç duket, kot po e pret dorën e mbarësisë!!! Megjithatë, edhe ky përkujtim i thjeshtë ka vlerën e vet, sepse populli përherë i mbajti në zemër!

Azem Galica lindi më 10 dhjetor 1889. I rritur në një familje me tradita luftarake e atdhetarie, që në fëmijëri u përcaktua në rrugën e lavdisë. I ati, Bejtë Galica, ishte ndër luftëtarët më të njohur të Drenicës, i cili ra heroikisht në betejën e njohur kundër Shemsi Pashës më 1907, në mes të Rezallës dhe Deviçit.

Gjatë viteve 1910-12 shpërthyen kryengritjet e përgjithshme për pavarësinë e tokave shqiptare. Më 5 maj 1912 Hasan Prishtina doli në Drenicë, në kullën e Ahmet Delisë, mbathi opingat dhe dha kushtrimin për një luftë mbarëkombëtare kundër Perandorisë Osmane. Edhe trimi 20-vjeçar radhitet në çetat e Drenicës dhe merr pjesë në betejën legjendare të Merdarit. Dhe, pas pak kohësh, Azem Galica bashkë me dy vëllezërit, Seferin e Zenelin, arrestohen dhe dërgohen në thellësi të Serbisë, në Zajeqar e në Pozharevc. As prangat e rënda nuk e penguan shpirtin e etur për liri. Në pranverën e hershme të vitit 1915 trimi u gjend në Drenicë.

Kthimi i tij ngjalli shpresat për ditë më të mira. Pa humbur kohë,



nën hijen e lisit trinjak në Galicë, formoi çetën luftarake, e cila më vonë do të bëhet nëna e çetave. Tashmë Azem Galica në çetën e tij kreshnike kishte edhe shoqen e jetës e të pushkës, kishte nusën e maleve - Shotë Galicën. Këta dy bashkëshortë e bashkëluftëtarë u bënë tmerr për armiq të pabesë. Një ditë, kur Azemi mungonte, forca të shumta austriake ia mësyjnë Galicës. Pas një lufte të rreptë, dy vëllezërit e tij, Seferi dhe Zeneli, vriten në malin Gamna. Betejën më të njohur kundër këtyre pushtuesve e zhvillojnë në Abri, më 6 mars 1917, ku plagoset për vdekje edhe vëllai i tij i vogël, Ademi. Nuk duhet harruar as aksioni i suksesshëm në Përrua të Keq, kur me pak trima zuri mbi 2000 ushtarë austro-hungarezë

dhe të gjithë i dorëzoi në Mitrovicë, te komandanti francez Balshe. Dhe betejat më nuk kanë të ndalur.

Pra, siç po shihet, Azem Galica që nga rinia e hershme u radhit në çetat e lirisë dhe për 12 vjet rresht, bashkë me nusën e maleve - Shotë Galicën, nuk i lëshuan armët nga dora. Ata zhvilluan mbi gjashtëdhjetë beteja fitimtare kundër pushtuesve më të mëdhenj perandorakë: Serbisë së Parë (1912-1915), austro-hungarezëve dhe bullgarëve (1915-1918) dhe Mbretërisë SKS (1918-1924).

Luftërat e tyre kishin karakter mbarëkombëtar dhe dirigjoheshin nga ideologu i madh Hasan Prishtina dhe Komiteti i Shkodrës, i cili edhe

kishte caktuar Azem Galicën komandant të të gjitha çetave çlirimtare shqiptare. Se ata punonin me program tregon fakti që, gjatë kryengritjes së madhe të vitit 1919, e cila nisi në Drenicë e përfundoi në Llapushë, ishin të mobilizuar 11 mijë luftëtarë nga të gjitha trevat shqiptare.

Në vitin 1923 qeveria serbe u detyrua të lëshonte pe karshi luftëtarëve shqiptarë. Kështu u krijua Zona e Lirë e Drenicës, që më shumë njihet si Arbëria e Vogël, e cila fillimisht përfshinte të gjitha fshatrat e komunës së atëhershme të Prekazit e më vonë kufizohet vetëm në: Galicë, Lubovec dhe Mikushnicë. Kjo bërthamë shtetërore për disa vite rrezatoi atdhedashuri mbi të gjitha trojet shqiptare dhe



frymëzoi luftërat tona çlirimtare. Në Beograd, atëbotë, reagimet ishin të ashpra. Më 11 tetor 1923 deputeti i Kosovës, Jovan Magovçevići, i inatosur tha: "Zotërinj, unë i kam dy vota: një si deputet i rregullt i Kuvendit Popullor dhe një si deputet i jashtëm i shtetit të Azem Galicës". Mirëpo, Serbia dinake, më 15 korrik 1924, ditën e tretë të Bajramit të Vogël, në mënyrë tinëzore, me mbi 1200 veta, ushtarë e xhandarë, rrethojnë këto tre fshatra. Ata me vete kishin marrë edhe shtatë topa të cilët i vendosën nëpër kodrat përreth...

Beteja që e përgjakshme dhe zgjati gjithë ditën. Kryetrimi, me ata pak luftëtarë që i kishte aty, sepse shumica kishin vajtur nëpër shtëpitë e tyre për të festuar, arritën t'i çajë të tri rrethimet.

Atë ditë të përgjakshme nga të dyja palët pati shumë të plagosur e të vrarë. Statistikat e kohës janë të ndryshme, por për të vrarë dominojnë shifrat 90 serbë e 83 shqiptarë. Nga tarët kryesisht ishin pleq, gra e fëmijë (në Galicë 35, në Mikushnicë 23 dhe në Lubovec 24). Kapedani i plagosur rëndë jetoi deri më 25 korrik 1924. Shokët e tij besnikë dhe e shoqja, Shotë Galica, trupin e tij e varrosen në varrin më të thellë në botë (73 metra), në shpellën "Çuku që kërcet" në malet e Përçevës.

Në krye të Çetës kreshnike u vu Shotë Galica, e cila me ca fëmijë jetimë kaloi në Shqipëri, derisa vdiq në mjerim të plotë, më 10 korrik 1927, në Fushë-Krujë. Shteti shqiptar trimëreshën Shotë Galica e shpalli heroinë dhe ia ngriti një lapidar të mrekullueshëm në Fushë-Krujë dhe një shtatore në Kukës.

Edhe Azem Galicën, Sali Berisha, më 26.01.1993, me dekretin nr. 435 e dekoroi me "Urdhrin e klasës së parë". Një tjetër dekoratë u nda edhe nga Republika e Kosovës e që ende nuk ka arritur të familjarët.

Azem Galica u bë UÇK

Hija e tij lëshoi rrënjë të thella në tokën e lashtë dardane. Mësuesi



○ .Arbëria e Vogël më 1923, e cila përfshinte të gjitha fshatrat e komunds së Prekazit.
● .Arbëria e Vogël më 1924 vetëm me tri fshatra.

Shaban Jashari u mësonte nxënësve për trimëritë e Azem Galicës. Më mirë se të tjerët amanetin e tij e kuptuan të bijtë, Hamza e Ademi, të cilët një ditë u bënë edhe vetë histori. Komandanti legendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, në tubimin e madh të mbajtur në Galicë, më 25 korrik 1990, që betuar se do ta vazhdojë rrugën e Tij, rrugën e madhe drejt lirisë! Fjala e kryetrimin nuk mbeti peng, ajo e bë realitet. Azem Galica u bë UÇK, e UÇK-ja u bë Azem Galicë!

Para obeliskut të tij në Galicë dhanë betimin shumica e komandantëve dhe luftëtarëve të lirisë. Një ditë të bukur, të javës së parë të prillit 1998, nipërit e tij, u mblodhën aty dhe u përbetuan: liri a vdekje! Njësitë e tyre suksesshëm veprori në kuadër të Batalionit III të Brigadës "Fehmi Lladrovci".

Barbaria serbe hyri edhe në

shkrepat e Arbërisë së Vogël. Dogji e shkatërroi çdo gjë. Edhe obeliskun e Azem Galicës e bëri copë-copë... Cerberët karpatianë edhe në mermer ia patën frikën. Dhe një ditë agoi ditë e bardhë! Azem Galicës sikur i buzëqeshte mustaku...

Edhe liria e shumëpritur ia bëhu në trojet që këta dy bashkëshortë për mbi 12 vjet i kishin mbrojtur me këngën e grykëhollës...

Por, mjerisht, fati, sërish, sikur ua ktheu shpinën! Trupat e tyre mbeten të ndarë, njëri në Galicë, tjetri në Fushë-Krujë!!!

Edhe më: Përkundër synimit të tyre që ta kemi një shtet, u krijuan dy! Dhe, këto dy shtete: Shqipëria dhe Kosova i nderuan me titujt më të lartë: hero! Por, ç'e do, or të keqen, kur asnjë dekoratë nuk ka arritur aty ku duhet: te familjarët!

Dhe moskujdesi ndaj heronjve vazhdon. Ata ende, as pas gati një shekulli, nuk kanë një shtatore!!!

Kthesa proamerikane e kryeministrit Kurti



Shkruan: Hisen BERISHA

Në "Prespa Forum Dialogue (PFD)" kryeministri Albin Kurti iu drejtua kryeministrit shqiptar, atij serb dhe maqedonas, se "në dëshpërim të moshapjes së negociatave për integritet evropian, po tentojnë që rajonin ta orientojnë kah federata ruse". Një shpresë që po duket si mirazh në syprinën e diplomacisë dhe politikës së jashtme të Kosovës, janë deklaratimet me orientim "proamerikan" të kryeministrit, që përbëjnë një kthesë inkurajuese për të ardhmen e Kosovës në partneritet të përhershëm me ShBA-në. Konsistenca e kryeministrit Kurti në qëndrimet e mbajtura në PFD, moskundërshtimi i marrëveshjes së Uashingtonit nëse ndodh, janë tregues orientimor se nuk i bën argat qeverisë serbe, e cila, për shkak të interesave ekonomike me Turqinë e Rusinë, po lufton për mosdërgimin e ambasadës serbe në Jerusalem.



Qëndrimi i deritanishëm i z. Kurti rreth marrëveshjes së Uashingtonit është beteja politike që pret ta fitojë Serbia pa luftë ndaj Shteteve të Bashkuar të Amerikës, pikërisht me argatin që po u bën kryeqeveritari i Kosovës me shpërfilljen e marrëveshjes së zotimeve të Uashingtonit. Kjo rrezikon potencialisht statusin special të Kosovës në marrëdhëniet imediate me Shtetin e Bardhë.

Befasia e radhës në politikën e jashtme të kryeministrit të Kosovës pritët të bëhet përplasja me Turqinë pikërisht për shkak të qëndrimit rreth ambasadës dhe të dërguarit/ës të Kosovës në Jerusalem.

Promovimi më tej i SEFTA alias Shengenit i Novisadit në përmbajtje dhe qëllim, tregon hapur se me statusin e tij prej kryeministri, me nismat rajonale jashtë përgjegjësisë amerikane, pretendon të qëndrojë më lart se marrëveshja Uashingtonit, ku Kosova kishte status të subjektit në marrëdhëniet ndërkombëtare, me ndërmjetësim garantues të superfuqisë së botës, ShBA-së. Po t'i referohemi deklaratimit të presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, që nismës antievropiane dhe antiamerikane të Novisadit - "Shengenit", Rama - Vuçiq, t'i ndërrohet emri, me siguri se në kontekst të katër propozimeve të kryeqeveritarit Kurti në Bruksel, do të përbëjë rrezik për "kthimin e Serbisë në Kosovë". Politika e Kosovës dhe vetë z. Kurti nuk bënë të harrojë se këto propozime nuk hyjnë në vendimmarrjen amerikane. Pastaj, në ShBA administrata shtetërore republikane apo demokrate nuk i ndryshon pozicionet rreth marrëveshjeve që vetë i sponsorizon.

Inkurajuese është deklarata "urdhëruese" e presidentit të ShBA-së, për pesë shtetet anëtare të BE-së, se "duhet ta njohin pavarësinë e Kosovës". Kështu që, politikëbërja e Kosovës dhe e vendeve të rajonit duhet të jetë në konstruktivitet me gjeostrategjinë politike të ShBA-së për rajonin.

Nuk duhet harruar se ka ndërrim të kursit politik në botë nga globalizmi për forcimin e shteteve kombëtare. Si rajon e me theks si Kosovë jemi pikërisht në këtë kurs veprimi.



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82**

Italia, 'mbretëreshë' e Evropës

Për Italinë ky është titulli i dytë i Evropës, derisa të parin e kishte fituar në vitin 1968. Ndërsa Anglia ende duhet të pret për të shijuar titullin e parë



"Epoka e re"

Londër, 11 korrik - Italia është "mbretëreshë" e re e Evropës, pasi në finale të Kampionatit Evropian "Euro 2020" e mposhti Anglisë pas ekzekutimit të penalltive me rezultat 3-2. Koha e rregullt dhe vazhdimet dy herë nga pesëmbëdhjetë minuta përfunduan me rezultat 1-1. Ishte Anglia ajo që kaloi e para në epërsi 0-1, vetëm pas dy minutave lojë. Shënues ishte mbrojtësi i Manchester United, Luke Shaw. Pjesa përfundoi me këtë rezultat, derisa në pjesën e dytë italianët ishin me kërkues dhe e

arritën golin e barazimit në minutën e 67-të, kur mbrojtësi Leonardo Bonucci e shfrytëzoi një tollovi në mbrojtjen e Anglisë dhe shënoi nga afërsia për 1-1. Ashtu si koha e rregullt, edhe dy vazhdimet nga pesëmbëdhjetë minuta përfunduan me rezultat të barabartë 1-1. Në penallti me e suksesshme ishte Italia që shënoi 3 penallti dhe humbi dy, derisa Anglia shënoi dy penallti dhe humbi tri të tjera. Për Italinë shënuan Berardi, Bonucci dhe Bernardeschi, kurse dështuan Belotti dhe Jorginho. Për Anglinë shënuan Kane dhe Maguire, kurse dështuan Rashford, Sancho dhe Saka. Për Italinë ky është titulli i

dytë i Evropës, derisa të parin e kishte fituar në vitin 1968. Ndërsa Anglia ende duhet të pret për të shijuar titullin e parë. Italia ishte pjesë e Grupit A, kurse në ndeshjen e parë e mposhti Turqinë (0-3), me rezultat identik mposhti edhe Zvicrën. Ndërsa ndaj Uellsit në ndeshjen e tretë fitoi 1-0. Me pas e eliminoi në përballje direkte Austrinë pas vazhdimëve (2-1). Në çerekfinale, Italia e mposhti Belgjikën (2-1), kurse në gjysmëfinale triumfoi pas penalltive ndaj Spanjës (4-2), koha e rregullt kishte përfunduar 1-1 dhe në finale e mposhti Anglinë pas penalltive 3-2.



SHKURT

'Nikli' sot fillon përgatitjet, Elshani konfirmohet në pozitën e trajnerit

Skuadra e Feronikelit është gati për sezonin e ri. Ky klub ka njoftuar se trajner i skuadrës do të jetë Faruk Elshani, kurse sot (e hënë) do t'i fillojë përgatitjet për sezonin 2021/22. Në stërvitjen e parë "Nikli" do t'i bashkohen edhe transferimet e reja. "Pas një takimi të lojtarëve me kryetrajnerin e Feronikelit, Faruk Elshani, u diskutua për planet e sezonit të ri 2021/22. Elshani u konfirmua edhe një herë nga klubi kryetrajner për sezonin që po hyjmë duke pasur edhe mbështetjen e lojtarëve, edhe të kryesisë së Feronikelit. Gjatë ditës së hënë pritet të fillojnë stërvitjet me intensitet më të lartë, në të cilat do të bashkohen edhe prurje të reja. Feronikeli falënderon të gjithë adhuruesit e klubit, në veçanti ata më besnikët që nuk e kursejnë përkrahjen e tyre asnjëherë", thuhet në njoftimin e Feronikelit.

Pas 12 vjetësh, Sheqerolli ndahet me Besën

Një nga lojtarët më të mirë në edicionin e fundit të FC Besës, Donart Sheqerolli, ka bërë me dije se është larguar nga klubi pejan. "Ju njoftoj që nga sot nuk do të jem më pjesë e Klubit të Futbollit FC Besa. Nuk është lehtë. Ata që më njohin nga afër e dinë për dashurinë që ndiej për Besën, për Pejën. Falënderoj të gjithë trajnerët që kam punuar për 12 vjet duke i kaluar të gjitha gjeneratat në FC Besa. Falënderim edhe për të gjithë bashkëlojtarët. Kënaqësi me nda fushën me shumë legjenda të futbollit të Kosovës. Faleminderit për respektin të gjithë tifozëve, tifogrupit 'Besa Boys'. Shumë suksese për FC Besa!", ka thënë Sheqerolli.

Almir Kryeziu përforcon Dritën

Nënkampionia e Kosovës në futboll, Drita, e ka prezantuar futbollistin Almir Kryeziu, i cili kampionatin e kaluar dërsiti fanellën e Arbërisë. Përmes një njoftimi në faqen zyrtare, klubi gjilanas ka zyrtarizuar transferimin e tij. Sulmuesi i krahut të majtë me "Intelektualët" ka nënshkruar kontratë trevjeçare. Vlen të theksohet se Kryeziu së fundmi ishte pjesë edhe e Përfaqësueses U21 të Kosovës. "Sulmuesi këmbëshpejtë Almir Kryeziu është përforsim ynë më i ri, i cili më parë ishte pjesë e KF Arbëria. Kryeziu, i cili së fundmi ishte edhe pjesë e Përfaqësueses së Kosovës U21, ka lidhur kontratë me klubin për tre vjetet e ardhshëm dhe do të shtojë edhe më shumë konkurrencën në ekip. Almiri do t'i bashkohet menjëherë ekipit dhe ta vazhdojë punën nën urdhrat e trajnerit Nuhii", thuhet në njoftimin e Dritës.

Lushtaku emërohet trajner i Drenicës

Skenderaj, 11 korrik - KF Drenica ka zgjedhur ikonat e saj për ta drejtuar shtabin teknik. Në postin e trajnerit është rikthyer Tahir Lushtaku, kurse ndihmës të tij janë emëruar Sami Geci, Brahim Vojvoda dhe Arton Hajdari,

kurse Bekim Xani është emëruar trajner i portierëve. "Kryesia e re e klubit ka bërë një hap të madh duke rikthyer në klub ikonat e futbollit të Drenicës. Pas emërimit të Besim Bajraktarit drejtor sportiv, Tahir Lushtaku

emërohet kryetrajner i Drenicës, i cili ndihmës do të ketë: Sami Geci, ish-kapiten legjendar i ekipit, Brahim Vojvoda, Arton Hajdari, i cili gjithashtu është ish-lojtar i Drenicës dhe Bekim Xani, i cili do të jetë trajner i

portierëve. Kryesia e re ka objektiva të qartë afatgjatë, prandaj marrëveshja me shtabin teknik është trevjeçare, me synim Evropën. Shtabi teknik brenda pak ditësh pritet të fillojë stërvitjet për edicionin e ri të garave



2021/2022", thuhet në njoftimin e KF Drenica.

Ndeshja Llapi - Shkupi zhvillohet me prani të tifozëve

PODUJEVË, 11 KORRIK - KF Llapi ka njoftuar se ndeshjen ndaj Shkupit do ta zhvillojë me praninë e tifozëve. Kjo ndeshje do të zhvillohet më 15 korrik në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë me fillim nga ora 20:00, kurse është e vlefshme për raundin e parë kualifikues në Konferencë Ligë. Klubi nga Podujeva ka njoftuar se kjo ndeshje do të zhvillohet me praninë e tifozëve dhe do të jetë ndeshja e parë në Kosovë në të cilën do të jenë të pranishëm tifozët.

"Ndeshja e dytë e raundit të parë kualifikues e Ligës së Konferencës ndërmjet KF Llapi dhe FC Shkupi, e cila zhvillohet më 15 korrik 2021 (e enjte) në orën 20:00 në stadiumin 'Fadil Vokrri', do të zhvillohet me praninë e shikuesve. Kryesia e klubit dhe trajneri Tahir Batatina, pas shumë vështirësive, kanë bërë të pamundurën për rikthimin e tifozëve në ndeshjen e dytë, ku mbështetja dhe prania e tifozëve është e domosdoshme për të kaluar në raundin tjetër kualifikues. Biletat e ndeshjes do të dalin në shitje nga dita e hënë. Për shkak të numrit të



limituar të biletave, pasi kapaciteti momental i lejimit të tifozëve është 15 %, biletat dhe procedura e shitjes do të fillojë në stadiumin 'Zahir Pajaziti' (në njoftimin e radhës do të njoftoheni për mënyrën e shitjes së biletave). Po ashtu, bazuar në rregulloren e UEFA-s lidhur me organizimin e ndeshjeve me tifozë në

kohë të pandemisë, biletat do të jenë vetjake, pra me emër dhe mbiemër. Për t'u pajisur me biletë është e domosdoshme prania e një dokumenti identifikues. Bazuar në manualin për pandeminë Covid, tifozët e pranishëm kërkohet të kenë edhe testin PCR negativ për të hyrë në stadium", thuhet në njoftimin e Llapit.

Argjentina mposhti Brazilin në finalen e Kupës së Amerikës

RIO DE JANEIRO, 11 KORRIK - Argjentina e mposhti Brazilin me rezultatin minimal 1-0 dhe e ngrehu për herë të 15-të Kupën e Amerikës duke barazuar rekordin e Uruguait që e ka fituar po kaq herë këtë trofe. Skuadra e Lionel Scaloni fitoi fal një goli fantastik të shënuar nga Angel Di Maria në minutën e 20, pas një pasimi të Rodrygo De Paul. Sulmuesi i PSG-së nuk fali dhe mposhti Edersonin me një parabolë, duke e çuar topin në rrjetë. Tifozët e paktë në stadium shpërthyen në festë. 1-0 pas 20 minutash, ndërkohë që në pjesën e parë nuk pati gol tjetër. Nga dhomat e zhveshjes Brazili doli më i motivuar dhe që në fillim u shfaq i rrezikshëm. Richarlison shënoi një gol, por më parë u kap në pozicion jashtë lojës, kurse një aksion më pas e ndali portieri Emiliano Martinez. Brazili,



pavarësisht prej zotërimit të topit, nuk është se krijoi ndonjë rast flagrant. Kështu Argjentina e ruajti

epërsinë dhe Messi, i shpallur Lojtari i Turneut, ngriti një trofe me kombëtaren e tij.

SHKURT

Nagelsmanni e dëshiron Chiesan në Bayern

Julian Nagelsmann pëlqen shumë Federico Chiesan. Ka shkruar "Bild" dhe e ka konfirmuar vetë trajneri i Bayernit në një intervistë të dhënë për të përditshmen gjermane. "Po, është shumë i fortë, por edhe shumë i shtrenjtë. Një lojtar fantastik sepse ka një dinamikë të pabesueshëm. E njoh prej shumë kohësh dhe mendoj se është i jashtëzakonshëm", ka thënë Nagelsmann. "Është shumë i shpejtë dhe një finalizues shumë i mirë. Gjithsesi, ne kemi 4-5 lojtarë të mëdhenj në sulm, janë të mjaftueshëm nëse nuk dëmtohen", ka shtuar Nagelsmann.

Marcelo, kapiteni i ri i Realit

Marcelo do të jetë në detyrën e kapitenit të Real Madridit pas largimit të Sergio Ramosit. 33-vjeçari brazilian është një lider në fushë për të 16-in sezon me radhë në gjigantin e La Ligës. "Është një nder dhe një përgjegjësi e jashtëzakonshme që të jem kapiten i klubit më të madh në botë. Jam jashtëzakonisht me fat. Kur jeni lojtar i Real Madridit ju duhet të zgjoheni herët çdo ditë dhe me dëshirë dhe këtë energji duhet ta kesh çdo sezon. Jam këtu për kohë të gjatë, por dëshira ende është këtu, madje ajo vazhdon të rritet. Po shikoj për suksese në sezonin e ri", ka thënë Marcelo.

Poirier fiton trilogjinë në raundin e parë, McGregor thyen këmbën

Trilogjia e UFC i takon Dustin Poirier. Amerikani ka mposhtur Conor McGregor në fundin e raundit të parë, pas një dueli shumë të fortë. Irlandezi 10 sekonda para përfundimit të raundit pati një problem në kavigje dhe nuk mund të luftonte më. Gjyqtari e mbylli ndeshjen dhe në fund shpalli fitoren e Poirier. Polemika pritet të jenë të shumta për këtë duel. Për McGregor kjo ishte humbja e pestë në karrierë dhe Dustin ia ka shkaktuar dy prej tyre, që janë të fundit.

Lëndim i frikshëm për Lozanon

Çaste dramatike gjatë ndeshjes Meksikë-Trinidad e Tobago, e vlefshme për fazën e grupe të Concacaf Gold Cup. Protagonist, fatkeqësisht për të, ka qenë Hirving Lozano. Pas vetëm 10 minutash lojë sulmuesi i Napolit ka depërtuar në zonën e rreptësisë, është shtyrë dhe është përplasur me forcë me kokë në gjurin e portierit Phillip. Një goditje me të vërtetë e fortë që e ka lënë pa ndjenja meksikanin, i cili nuk ka lëvizur për disa minuta. Në sekondat e para pas lëndimit, gjyqtari nuk e ka ndaluar ndeshjen dhe vetëm pasi i është tërhequr vëmendja nga futbollistët e Meksikës ka kuptuar seriozitetin e situatës. Lozano duket se ka humbur ndjenjat për disa çaste dhe është transportuar menjëherë në spital i shtrirë në barelë. Gjendja e tij është e qëndrueshme dhe nuk ka pasur komplikime të tjera, siç kanë bërë me dije nga Meksika.

Ramosi: PSG-ja e etur për Ligën e Kampioneve

Sergio Ramos sezonin tjetër do të luajë sërish në Ligën e Kampioneve, por me një fanellë krejtësisht tjetër. Do të jetë habitëse ta shohësh në fushë një lider si Ramos me fanellë tjetër,

por ashtu do të ndodhë, ai është larguar nga Real Madridi për t'u transferuar te Paris Saint Germaini. Ai shpreson ta ndihmojë Parisin që të triumfojë në Ligën e Kampioneve, në

garën, sipas të cilit, PSG-ja është shumë afër që t'i dalë në krye. "Ajo që vura re më shumë në lidhje me këtë klub është forca e tij. Etja për fitore që kanë lojtarët. Ata duan të vijnë në një klub si ky. Ata

kanë luajtur tashmë në finalen e Ligës së Kampioneve. Janë shumë afër që të fitojnë atë dhe kjo është diçka që më tërheq. Mund të jetë një martesë e përsosur. Nëse mund të

kontribuoj në të, kjo do të ishte e mrekullueshme për mua. Është një ëndërr të mendosh për të fituar Ligën time të pestë të Kampioneve dhe të parën për klubin tonë", ka thënë Ramosi.



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 12.07.2021

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të rregullit 21 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; të neneve 6, 11, 12, 13 dhe 14 të Rregullores Nr. 03/2019 të Njësisë Ligjore, Sekretaria shpall:

KONKURS Për plotësimin e vendit të punës

1.	
Pozita:	Këshilltar i Lartë Kushtetues Juridikë
Kodi:	GJ-NJL 02-09
Numri i vendeve të punës:	2 (dy)
Kohëzgjatja e kontratës:	Pa afat
Puna Provuese:	1 (një) vit

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës

Nën mbikëqyrje të këshilltarit të Parë kushtetues juridik dhe të gjyqtarëve përkatës, mbështet punën profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë hulumtime ligjore dhe analiza dhe duke ndihmuar në hartimin e vendimeve, të raporteve dhe të materialeve të tjera juridike të hartuara nga Gjykata Kushtetuese.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- ndihmon në përgatitjen e raporteve paraprake, vendimeve dhe materialeve të tjera ligjore që ndërlidhen me juridiksionin e Gjykatës;
- bën analiza kushtetuese dhe ligjore;
- merr pjesë në seanca shqyrtuese dhe mban shënime për rastet;
- përgatit opinionione kushtetuese-ligjore sipas kërkesave të Kryetarit apo gjyqtarëve të Gjykatës;
- monitoron dhe udhëzon Këshilltarët Kushtetues Juridikë lidhur me detyrat që u janë caktuar atyre në rastet;
- kontribuon në funksionimin efikas dhe efektiv të Njësisë Ligjore si dhe kryen detyra tjera që kërkohen nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik;
- përgjegjës për të siguruar kualitetin e vendimeve të Gjykatës në rastet në të cilat janë caktuar; dhe
- përgjegjës për të mbështetë hulumtimin, analizën dhe hartimin e mendimeve mospajtuese dhe konkurruese sipas këshillës së gjyqtarit.

Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme

- Përgatitja e avancuar universitare në shkencat juridike, me ekspertizë në të drejtën publike, të drejtën kushtetuese, të drejtësisë kushtetuese dhe të të drejtave të njeriut;
- Pesë (5) vite përvojë profesionale juridike;
- Njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze.

Kandidati për pozitën e këshilltarit të lartë kushtetues juridik duhet të posedojë njohuri të thella profesionale, si dhe aftësi të shkëlqyeshme hulumtuese, analitike dhe organizative.

Po ashtu, kandidati duhet të demonstrojë qasje pragmatike në gjetjen e zgjidhjeve adekuate me burime të kufizuara, të ketë aftësi të zhvilluara komunikimi (në mënyrë verbale dhe me shkrim), të ketë aftësi për të identifikuar prioritetet, të ketë aftësi për të bashkëpunuar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë; të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive nën presion kohor; të ketë aftësi për të trajtuar informatat e besueshme në mënyrë të duhur; të ketë aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, dhe hulumtimin në internet.

Informata të përgjithshme për kandidatët

Përcaktimi i pagës, për pozitën e shpallur, bëhet në përputhje me Rregulloren e punës dhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret aplikacionet nga personat e komuniteteve joshumicë dhe nga kandidatet femra. Politika e përfaqësimit gjinor dhe të të gjitha komuniteteve të Kosovës do të zbatohet gjatë procesit të punësimit në Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe me dokumentacion përkatës lidhur me përgatitjet shkollore dhe përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese www.gjk-ks.org

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në kopje fizike në Zyrën e Departamentit të Administratës dhe Burimeve Njerezore (DABNJ) të Gjykatës Kushtetuese.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve, nëpërmjet e-mailit, nëpërmjet shërbimit postar apo në Zyrën e Personelit të Gjykatës Kushtetuese, është më **26.07.2021, në orën 16:00.**

Shënim: Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Perandori Justinian , nr 44, 10000 Prishtinë/a, Kosovë/o
Tel: +383 (0)38 606 162; Fax: +383 (0)38 606 170; www.gjk-ks.org



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtina, 12.07. 2021. godine

Shodno çlanu 13. Zakona o Ustavnom sudu Republike Kosovo, br. 03/L-121, pravilu 21. Poslovnika o radu Ustavnog suda Republike Kosovo, kao i u skladu sa članovima 6, 11, 12, 13 i 14 Uredbe br. 03/2019 za Pravnu jedinicu, Sekretarijat objavljuje:

KONKURS za popunjavanje radnog mesta

1.	
Pozicija:	Viši ustavno pravni savetnik
Kod:	GJ-NJL 0-09
Broj radnih mesta:	2 (dva)
Trajanja ugovora:	Neodređeno
Probni rad :	1 (jedna) godina

Opšti opis pozicije

Pod nadzorom glavnog ustavno pravnog savetnika i relevantnih sudija podržava profesionalni rad sudija Ustavnog suda, vršeci pravna istraživanja i analize i pomažući u sastavljanju odluka, izveštaja i ostalog pravnog materijala koji priprema Ustavni sud.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- pomaže u pripremi preliminarne izveštaja, odluka i drugih pravnih materijala koji se odnose na jurisdikciju Suda;
- vrši ustavne i zakonske analize;
- učestvuje na sednicama za razmatranje i vodi beleške o slučajevima;
- priprema ustavno-pravna mišljenja na zahtev predsednika ili sudija Suda;
- nadgleda i daje instrukcije ustavno pravnim savetnicima u vezi sa zadacima koji su im dodeljeni u slučajevima;
- doprinosi efikasnom i delotvornom funkcionisanju Pravne jedinice i obavlja i druge zadatke na zahtev glavnog ustavno pravnog savetnika;
- odgovoran je za osiguranje kvaliteta odluka Suda u slučajevima na kojima je određen;
- odgovoran je da podržava istraživanje, analizu i izradu suprotnih i podudarnih mišljenja u skladu sa savetom sudije.

Minimalne kvalifikacije i opšte iskustvo:

- napredno univerzitetsko obrazovanje u oblasti pravnih nauka, sa ekspertizom u oblasti javnog prava, ustavnog prava, ustavne pravde i ljudskih prava;
- 5 (pet) godina profesionalnog pravnog iskustva;
- odlično poznavanje engleskog jezika.

Kandidat za poziciju višeg ustavno pravnog savetnika treba da ima odlično profesionalno znanje kao i odlične istraživačke, analitičke i organizacione sposobnosti.

Kandidat takođe treba da dokaže pragmatičan pristup u pronalaženju adekvatnih rešenja sa ograničenim resursima, razvijene sposobnosti komunikacije (pismene i usmene), sposobnost identifikovanja prioriteta, odlične sposobnosti časnog i poštenog rada u saradnji sa kolegama i strankama, treba biti spreman za efikasan rad u kratkim vremenskim rokovima, spreman na rad sa poverljivim informacijama; treba odlično poznavati rad na kompjuteru i istraživanja na Internetu.

Opšte informacije za kandidate

Određivanje plate za objavljeno radno mesto se vrši u skladu sa Poslovníkom o radu i odlukom Ustavnog suda.

Ustavni sud pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim kandidatima i ohrabruje sve osobe ženskog pola i pripadnike ne većinske zajednice da konkurišu. Politika jednake zastupljenosti polova i svih zajednica koje žive na Kosovu će se sprovoditi tokom procesa zapošljavanja u Sekretarijatu Ustavnog suda Republike Kosovo.

Procedura konkurisanja

Zainteresovani kandidati treba da podnesu odgovarajući zahtev, kome prilažu profesionalnu biografiju, motivaciono pismo, kao i odgovarajuću dokumentaciju o stručnoj spremi i potrebnom radnom iskustvu.

Zahtev se može dobiti u štampanoj formi na prijavnici Ustavnog suda, a može se i preuzeti sa internet stranice Ustavnog suda www.gjk-ks.org.

Zahtev i sva ostala dokumenta mogu se poslati putem elektronske pošte na sledeću email adresu: gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org, putem poštanske službe ili u štampanoj formi u kancelariji Odeljenja za administraciju i ljudske resurse (OALJR) Ustavnog suda.

Poslednji rok za prijem zahteva, putem emaila, poštanske službe ili u Odeljenju za administraciju i ljudske resurse Ustavnog suda, je **26.07.2021. godine, u 16.00 časova.**

Napomena:

Zahtevi podneti nakon poslednjeg datuma neće biti primljeni. Nekompletni zahtevi mogu biti odbijeni. Zbog velikog broja primljenih zahteva, biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor.

Perandori Justinian nr.44, 10000 Prishtinë/a, Kosovë/o
Tel: +383 (0)38 606 162; Fax: +383 (0)38 606 170; www.gjk-ks.org

FTESË PËR OFERTË

datë:12.07.2021

"EBE" SH.P.K.

Tel.+38349207580

e-mail:q.hoti@yahoo.com

NUI.811150614

Adresa"objekti afarist "DARDANIA",rruga "R. Kombëtare",pn.,Malishevë

Objekti i kontratës:"Improved competitiveness of fruits producers through establishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards"

Të nderuar Zonja/zotëri, "EBE SH.P.K. ju fton që të paraqitni ofertën tuaj për zbatimin e projektit të bashkë financuar nga EU dhe EBE sh.p.k., "Improved competitiveness of fruits producers through establishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards",

loti 1, Loti 2, Loti 3, Loti 4, Loti 5, Loti 6

Kriteret e përzgjedhjes:Tenderi me çmimin më të ulët

Kontrata do të konsistoj në kryerjen e furnizimeve dhe shërbimeve për implementimin e projektit të lartë cekur

Lloji i kontratës:Furnizim dhe shërbime

INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

Afati i fundit për pranimin e kërkesave për dosje data:30.07.2021

Dokumentet per ofertim munde te merren ne formë elektronike ne adresen,

q.hoti@yahoo.com

Afati kohor për pranimin e ofertave: data 02.08.2021,deri në orën 13,vendi në objektin afarist Daradania ne rrugën Rilindja Kombëtare pn,Malishevë.

Ofertat e sjellura pas ores 13 nuk do te pranohen.

Takimi per hapjen e ofertave:data 02.08.2021,koha 13:30h ,vendi në objektin afarist "Dardania" në rrugën "R. kombëtare" Malishevë.

Vlerat e parashikuara :

Loti 1,certifikimi me HACCP,vlera 3,000 €**Loti 2,furnizimi me piruner dore,vlera 2,000.00€****Loti 3,furnizimi me arka PVC për pemë,vlera 16,500.00€****Loti 4,furnizimi me karroca për bartjen e arkave,vlera 4,500.00€****Loti 5,furnizimi me system te energjis solare,vlera 25,600.00 €****Loti 6 ,realizimi i auditimit,vlera 2000€**

informacionet plotsuese nga data 22.07.2021 deri me daten 27.07.2021 gjat diteve te punes

INVITATION OFFER

Date:12.07.2021

"EBE"LLC

Tel.+38349207580

e-mail:q.hoti@yahoo.com

UIN.811150614

Address "DARDANIA"Building,street "R. Kombëtare",pn.,Malishevë

Aim of thr contract:"Improved competitiveness of fruits producers through establishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards"

Dear Mr/Mrs

"EBE"LLC. Invites you to present your offers for the execution of the the project co founded by EU and EBE LLC for :**"Improved competitiveness of fruits producers through establishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards", lot 1,Lot 2,Lot 3,Lot 4,Lot 5,Lot 6.**

Selection Criteria:The lowest price tendering

The contract will consist of services and supplies for the implementation of the above mentioned project

Type of contract: services and supplies

Administrative information

The deadliner for submission of requests and bid offers is on: 30.07.2021

The tendering documents can be received via electronic at: q.hoti@yahoo.com

Deadline for receiving offers:date 02.08.2021 to 13:00 Am in the building"Dardania" street "R. Kombëtare" Malishevë.

Offers submitted after 13:00 Am will not be accepted.

Meeting for the opening of the offers :date 02.08.2021 ,time 13:30 Am,building locatin

"Dardania" street "R.Kombëtare" Malishevë

The estimated value of the lots:

Loti 1,HACCP certificate,value 3,000 €**Loti 2,purchase of the mechanical fork for the collection centre ,value 2,000.00€****Loti 3,purchase of boxes for collection fruits,value 16,500.00€****Loti 4,purchase of applear for conveyance of boxes,value 4,500.00€****Loti 5,Purchase of solar energy system,value 25,600.00 €****Loti 6 ,expenditure verication /audit,value 2000€**

Additional information on: 22.07.2021 to 27.07.2021 during working days.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "3 MIX" SH.P.K. me nr. 810774655 bënë zvogëlim të kapitalit nga 950.000.00 në 5.000.00.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues